

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE, me gjyqtarin Mr.sc.Bajram Miftari, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve, ["A.D"] nga Kamenica, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit ["B.I"], avokat nga Prishtina, kundër të paditurve Komuna e Ranilluku dhe Agjencia e Kadastrale e Kosovës, objekt i kontestit kompensim dëmi, pas shqyrtimit para rak të padisë, me datën 22.05.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Departamenti për Çështje Ekonomike, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, shpallet jo kompetente, në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lënda së bashku me të gjitha shkresat sajë, do t'i dërgohet Gjykatës Themelore në Gjiilan.

A r s y e t i m

Paditësja ["A.D"] me datën 22.02.2019, në këtë gjykatë ka paraqitur padi, kundër të paditurve, Komuna e Ranillukut dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për kompensim dëmi. Në padi ndër të tjera kanë theksuar se pas një procesi të hapur dhe transparent në tenderin e shpallur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka lidhur kontratën për privatizimin e një numri të parcelave. Pas lidhjes së kontratës Zyres Komonale Kadastrale të Komunës së Ranillukut është drejtuar me kërkesë për regjistrimin e patundshmërisë së privatizuar, mirëpo, Zyra Komonale e Kadastrit pranë Komunës së Ranillukut, për arsye të pa njohura dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore ka refuzuar që ta bëjë regjistrimin e parcelave. I është drejtuar me ankesë Komisionit të Ankesave të Komunës, i cili e ka refuzuar ankesën e parashtruar. Pastaj me datën 15.07.2014, i është drejtuar me ankesë edhe Agjencisë Kosovare të Kadastrit, i cili e ka miratuar ankesën e sajë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Me datën 23.03.2015, Zyra Kadastrale Komonale e Komunës së Ranillukut ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar kërkesën e sajë për regjistrimin e parcelave në regjistra publike. Ka shtuar se me datën 21.08.2015, ka parashtruar padi Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, i cili me aktgjykimin A.nr.1510/15, ka aprovuar kërkesëpadinë dhe me datën 07.08.2018, nga Agjencia Kadastrale e Kosovës është njoftuar se AKK me aktvendimin me numër 03/511/14 e ka detyruar Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit të Komunës së Ranillukut regjistrimin e pronës dhe përfundimisht me datën 25.10.2018, është bërë edhe ekzekutimi i aktvendimit për regjistrimin e pronës. Ka mbajtur qëndrimin se për shkak të neglizhencës së regjistrimit të pronës është shkaktuar dëm në formë të fitimit të humbur.

Me nenin 19 të LPK-së, është përcaktuar se gjykata gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën lëndore.

Nga padia dhe shkresat e bashkangjitura shihet se paditësit në cilësinë e personit fizik kanë parashtruar padi për kompensim dëmi, kundër të paditurave Komuna e Ranillukut dhe Agjencia

G 23.05.19

Kadastrale e Kosovës dhe ka propozuar që të detyrohen të paditurat që t'ia kompensojnë dëmin në formë të fitimit të humbur, për shkak të pa mundësisë së shfrytëzimit të parcelave të cilat i ka privatizuar nga AKP-ja.

Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit në aspektin e kompetencës së gjykatës, ka ardhur në përfundimin se ky departament nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses. Me dispozitat e nenit 13 të Ligjit për Gjykatat është përcaktuar kompetenca lëndore e Departamentit për Çështje Ekonomike, ku është theksuar se ky Departament është kompetent për të vendosur në kontestet ndërmjet personave juridikë vendor dhe të huaj, lidhur me çështjet e tyre afariste.

Paditësit, me padi ka theksuar se ka privatizuar prona të pa luajtshme nga AKP-ja, dhe se është shkaktuar dëm ngase, ka pasur vonesa në regjistrimin e pronës në regjistra publik dhe si rezultat e këtyre vonesave nuk ka mundur që ta përdorë pronën për destinimin e caktuar. Mirëpo, nga referati i padisë shihet se në rastin konkret kemi të bëjmë me palë paditëse e cila është person fizik. Rrjedhimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent për të vendosur sipas padisë së personave fizik siç është rasti këtu me paditësen. Për arsyet e lartcekura, gjykata erdhi në përfundimin se nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Me dispozitat e nenit 11.1 të Ligjit për Gjykatat është përcaktuar kompetenca e përgjithshme lëndore e gjykatave themelore të vendit, ku është përcaktuar se Gjykata Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet përpos nëse në ligj parashihet ndryshe. E me nenin 47 të LPK-së, në kontestet për përgjegjësinë jo kontraktuale të dëmit përveç kompetencës së përgjithshme territoriale, kompetente është dhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues, dhe në territorin e së cilës ka lindur pasoja. Meqenëse, paditësi pretendon se dëmi i është shkaktuar në territorin e Komunës së Ranillukut, gjykata ka ardhur në përfundimin se kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore është Gjykata Themelore në Gjiilan.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
I.EK.nr.101/2019, me datën 25.05.2019

Gjyqtari,
Mr.sc. Bajram Mitari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

Republika e Kosovës
VENDIMI I SHITË I PLOTËFUQISHEM
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI EKONOMIK
25.05.2019